



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



KUVENDI KOMUNAL

01 Nr. 29 /24

Më 29.11 /2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d) Ligji Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 5 paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.1.2, neni 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, neni 11, 15 dhe neni 26 i Ligjit 04/L-174, Për Planifikim Hapësinor, lidhur me nenin 5 i Udhëzimit Administrativ MMPH-nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor Komunal, si dhe Stautit të Komunës së Mamushës 01/2008 e datës 01.12.2008, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me datën 29.11.2024 mori këtë

V E N D I M

Për Hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës 2025-2035

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillon hartimi i Planit Zhvillimor Komunaë 2025-2035 të Komunës së Mamushës.

Neni 2

Përkufizim i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, plani zhvillimor komunal në harmoni me ligjin, si plan strategjik multi sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plan i zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave për periudhën (10) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plan i Zhvillimor Komunal në harmoni me Ligjin si Plan Strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjate të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plan i zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave për periudhën (10) vjeçare.

Neni 4

Kufiri i Territorit

Komuna e Mamushës përbëhet vetëm nga një zonë kadastrale me sipërfaqe prej 10.94 km².

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartimin e planit

Bartës i hartimit të Planit zhvillimor Komunal është sektori Kompetent Komunal për Planifikim Hapësinor Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm, për hartimin e planit

Mjetet për përgatitjen e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohet nga buxheti i komunës së Mamushës. Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër, koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me Drejtoritë të tjera.

Neni 7

Afati i hartimit

Në bazë të nenit 1 të këtij vendimi, bartësit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor është i obliguar që në afat prej 24 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta përpiloj dokumentin e planifikimit hapësinor.

Neni 8

Konsultimet publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal, para finalizimit të tij, duhet të vihet në konsultim publik dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e planit zhvillimor komunal për shqyrtim publik dhe koha e dorëzimit të shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallet përmes shpalljeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Ky dokument do të hartohet për një periudhë 10 vjeçare nga 2025 deri 2035

Neni 10

Gjuhë zyrtare

Sipas nenit 1 të këtij vendimi, Plani zhvillimor komunaë duhet të jetë në gjuhë zyrtare të komunës dhe më së paku 3 kopje të shtypura dhe të vulosura në origjinal.

Neni 11

Programi

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në wëp faqe të Komunës së Mamushës, sipas kushteve të parapara në nenet 81 dhe 82 të LVL-ës.

KUVENDI KOMUNAL MAMUSHË

*Zyra e Kryetarit
Drejtoritë Kadastrit
MAPL
Arkivit*

